



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.615/2017

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Skender Shala dhe me bashkëpunëtorin profesional Blerim Istrefi, ne çështjen juridike te paditëses: **I.P** nga te cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av.ZA nga, kundër te paditurës: Komuna e- Qendra Kryesor e Mjekësisë Familjare, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin ne emër te pagave përcjellëse për ne pension, pas mbajtjes se seancës kryesore publike me dt.03.01.2019, me dt. 09.01.2019 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHET e paditura Komuna e - Qendra Kryesor e Mjekësisë Familjare t'ia paguajë paditëses I.P nga, në emër te pagesës së 3 pagave për shpërblim jubilar pas pensionimit dhe 3 pagave përcjellëse për periudhën e punës prej 44 vite e 1 muaj e 2 ditë, shumën totale prej 2,868.66 €, te gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm

OBLIGOHET e paditura Komuna e - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Dr. t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja përmes te autorizuarit te sajë17.10.2017 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension.

Gjykata, me dt. 03.01.2019, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses, dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditëses në seancë të shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur me shkrimi propozoi gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, po ashtu shpenzimet e procedurës kontestimore.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë duke pasur parasysh mungesën e mjeteve buxhetore për pagesën e pagave të kërkuara nga paditësja të cilin e ka buxheti komunal edhe pse është e evidente se paditësja ka punuar tërë kohën e theksuar në padi të e paditura dhe kjo është jo kontestuese, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve nuk kemi mundur deri me tani ta përmbushim këtë obligim ndaj paditëses.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kërkesa e paditëses drejtuar të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë dhe atyre përcjellëse me rastin e pensionimit të dt.13.10.2017, Vendimi i MPM Departamenti i Pensioneve i dt.05.07.2017, Vërtetimi për përvojën e punës dhe të ardhurat personale në emër të paditëses i dt.12.05.2017 lëshuar nga MPMS Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, vërtetimi mbi përvojën e punës në emër të paditurës i dt.11.05.2017 lëshuar nga MPMS Departamenti i Pensioneve në ..., Vërtetimi i lëshuar nga QKMF-Zyra e Personelit në ... i dt.11.10.2017 lidhur me përvojën e punës së paditëses, Pasqyra- gjendja e llogaris bankare e dt.12.10.2017 lëshuar në emër të paditëses, dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti që paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura nga data: 10.04.1973 e deri me 12.05.2017, ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit të datës: 12.05.2017 dhe 11.05.2017 të lëshuar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i pensioneve, si dhe nga vërtetimi i dt.11.10.2017 lëshuar nga e paditura po ashtu edhe nga thinjet e palëve në padi si dhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë

Nga vërtetimi i dt. 11.10.2017 vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare në ... si Teknike Laborante e Mjekësisë deri me 12.05.2017.

Nuk është kontestues se paditësit i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension të pleqërisë me dt.12.05.2017, e kjo vërtetohet nga vendimi me nr. 246 të dt.08.05.2017 lëshuar nga e paditura.

Nuk është kontestues fakti se paditësja është përfituese e pensionit te pleqërisë në shumë prej 172 €, ky fakt vërtetohet nga vendim i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve i dt. 05.07.2017.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës bazë që paditësi e ka realizuar nga e paditura në tre muajt e fundit para pensionimit është shuma mujore prej 478.11 € ku kjo vërtetohet nga gjendja e qarkullimit të llogaris së paditëses, ku shihet qarte se paga ka qenë ajo që përmendet më lartë.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditurës duke e kontestuar padinë për shkak të mjeteve financiare, pretendim të lartcekur gjykata e refuzoj si të bazuar, duke u bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, andaj për vendosje sipas pikës I të dispozitivit

sa i përket pagesës së tri pagave në emër të shpërblimit jubilar iu referua nën 52 par 1 nën par. 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me të cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit t’i njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësia të tri pagave mujore të tij”, e në rastin konkret paditësja ka qenë e punësuar të e paditura për më shumë se 44 vite, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes në emër të kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua në nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me të cilën parashihet “I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit.

Bazuar në nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që të paguaj kompensimin për dy kategori të lartcekura.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro në emër të përpilimit të padis dhe 40 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.615/2017, datë 09.01.2019

GJYQTARI
Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimet te të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.